

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Pjesë këmbimi dhe riparim mjetesh, blerje goma dhe bateri”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pjese kembimi per automjete, furgone dhe makina furnizim mallrash. Kodi 34330000-9

VLERA E FONDIT LIMIT:

5.833.333 (pesemilion e tetqinde tridhjetë e tre mijë e treqinde tridhjetë e tre) leke pa përfshirë vleftën e TVSH-së

I mbajtur sot me date 14.05.2024 ne Autoritetin Kontraktor Bashkia Finiq, ne mbledhjen e njesise se prokurimit te perbere prej Florida Lula, Eduart Merkuri, Vangjel Kaçi ngritur sipas Urdhërit te Prokurimit Nr.12, datë 09.05.2023 per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve te veçanta te pranimit te procedurës se prokurimit me objekt: “Pjesë këmbimi dhe riparim mjetesh, blerje goma dhe bateri”, prokurim elektronik “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me fond limit 5.833.333 (pesemilion e teteqinde tridhjetë e tre mijë e treqinde tridhjetë e tre) leke pa përfshirë vleftën e TVSH-së, sipas perllogaritjeve te kryera.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Finiq ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe VKM-se Nr 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”e ndryshuar.

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023, ku vlera e xhiros duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës qe prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (b) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022,2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c", të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të

kontabilistit të miratuar” , ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3. Vertetim të leshuar nga autoritetet vendore, për shlyerjen e taksave vendore në zbatim të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Për plotësimin e kriterit të mesipër të pikës është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit).

Ne lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, mbajme në konsideratë përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2 të këtij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertes, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ”Liçence profesionale Kodi VII.3.B.1” të leshuar nga Qendra Kobetare e Biznesit (QKB) për veprimtarite:

VII.3.8.1/a – Riparim dhe mirembajtje e pjeseve mekanike dhe te motorit, te mjeteve.

VII.3.8.1/b – Riparim dhe mirembajtje e karrocereve ,te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.8.1/c – Riparim dhe mirembajtje e impiantit elektrik te mjeteve rrugore me motore dhe rimorkiove.

VII.3.8.1/ç – Riparim dhe mirembajtje e gomave te mjeteve rrugore me motore dhe rimorkiove.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Në bazë të liçences profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që ne kërkojmë të prokurojme.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 2 (dy) persona**.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ne zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:

- Listpagesat sipas formularit satandart për sigurimet
- Vertetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit** për mjetet në rastet e difekteve nga adresa e autoritetit kontraktor deri në servis, si dhe të pjesëve të këmbimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.5 Duke patur parasysh natyrën e shërbimeve që kërkohen operatori ekonomik duhet të ushtroje aktivitetin brenda territorit të Bashkisë Finiq. Për të vertetur këto dihet të paraqesë dokumentin e pronësive/apo kontratën e qerases të objektit në të cilin ushtron aktivitetin e tij, të shoqëruar me planvendosjen përkatëse.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mesipër në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ne zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:

- Dokumentin e pronësive
- Kontratën e qerases, shoqëruar me dokumentin e pronësive

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Automjet transporti me kapacitet mnbajtes jo më pak se 1(një) Ton për rastet kur automjetet e AK pesojnë difekte , ndodhen larg servisit të OE dhe kanë të nevojshme asistencën teknike.Për këte OE duhet të paraqese Aktin e pronësisë së mjetit perkatës;Ose Kontratën e marrjes me qira të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës tëpronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale.Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore .
- Disponimin e 1 (nje) ure ngritëse.
- Vinç ure me kapacitet ngrites ja me pak se 3 ton per sherbimet ndaj mjeteve te renda.
- Aparat per matjen dhe karikimin e baterive.
- Aparate saldime perçinimi.
- Motokompresor ajri.
- Gropa cope 2 per riparimin dhe kontrollin e mjeteve te tonazhit të madh me gjatësi jo më të vogël se 10 ml.
- Pompe grasatimi.
- Operatori Ekonomik për të realizuar kontratën duhet të disponojë Ambiente (ndërtesë+ambjente suportuese) me një sipërfaqe të përgjithsme prej jo më pak se 500 m2 .
- Presë për montimin e bokollave, kushinetave.
- Pajisje per saldime hekuri dhe saldime me oksigjen.
- Kriko ngritje-ulje kamjo.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne renditje pas mbylljes se fazes se vleresimit duhet te dorezoje prane AK,perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, te gjithe dokumentacionin provues si me poshte:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit;b)leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a)dokumentit qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës që prokurohet dhe afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas formularit përmbledhes se vetdeklarimit.
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë te

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

1. Vaji i motorit duhet të jete cilesor dhe origjinal i shoqeruar edhe me certifikaten CE **(ose ekuivalente)**. Filtrat e mjeteve duhet të jene cilesor dhe të shoqeruar me certifikaten CE **(ose ekuivalente)**.
2. Nderrimi i vajit dhe filtrave do të kryhet në varesi të kilometrave dhe në varesi të cilesise të vajit. Kjo do të varet gjithashtu edhe nga garancia që do të japë ofertuesi për sasine të kilometrave me vajin që do të ndërrohet.

3. Shërbimet e tjera të mjeteve do të kryhen gjatë gjithë periudhës me akt konstatimet e defekteve dhe me miratimin e specialistëve të AK.
4. Në rastet e ndodhjes së defekteve të mjeteve në qarkullim brenda ose jashtë territorit të Bashkisë Finiq, operatori ekonomik ofertues duhet të kryejë me shpenzimet e veta transportin e mjeteve pranë servisit.
5. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të bërë verifikimin e objektit (servisit), makinerive dhe pajisjeve të sipër përmendura sipas ketyre kërkesave.

Sa me sipër Njësia e Prokurimit

Vendosi:

1. Miratimin e specifikimeve teknike të objektit “Pjesë këmbimi dhe riparim mjete, blerje goma dhe bateri”.
2. Miratimin e krieteve të veçanta të procedurës së prokurimit me objekt “Pjesë këmbimi dhe riparim mjete, blerje goma dhe bateri”.
3. Në zbatim të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021, neni 45, pika 2, Kriter vlerësues të jete:
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim
4. Procedura për hapjen e ofertave do të zhvillohet në datën 09.07.2024, Ora 09⁰⁰

Në zbatim të Udhezimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr.7, datë 30.07.2021”Për mënyrën e zhvillimit të prokurimeve me mjete elektronike”, pika 3, Manuali teknik, Njësia e Prokurimit autorizon z.Florida Lula për të kryer veprimet në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

PER NJESINE E PROKURIMIT